REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 102/17
Datë/Datum. 12.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE

PSH. Nr. 102/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-237, me ligjin nr.05/L-068 dhe me ligjin 05/L-92, në përbërje prej z.Tefik Sylejmani - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – referues, z. Ekrem Salihu – anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Dromodoli Comerc" nga Peja, kundër autoritetit kontraktues/ Komuna Novobërdë, lidhur me aktivitetin e prokurimit, për tenderin me titull: "Shitja masës drusore të pa prerë në njësinë menaxhuese Novobërdë – Kodra e Madhe, me lloj të trajtimit Rrallime", me nr. të Prokurimit: NB 654 17 001 AP, me dt. 24. maj 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet**, ankesa e operatorit ekonomik: "Dromodoli Comerc" nga Peja, me nr. 102/17, parashtruar kundër autoritetit kontraktues Komuna Novobërdë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shitja masës drusore të pa prerë në njësinë menaxhuese Novobërdë – Kodra e Madhe, me lloj të trajtimit Rrallime, me nr. të Prokurimit: NB 654 17 001 , si e bazuar.

II. **Anulohet,** vendimi, i Autoritetit Kontraktues / Komuna Novobërdë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Shitja masës drusore të pa prerë në njësinë menaxhuese Novobërdë – Kodra e Madhe, me lloj të trajtimit Rrallime, me nr. të Prokurimit: NB 654 17 001, si i pa bazuar.

III. **Obligohet,** Autoritetit Kontraktues / Komuna Novobërdë, që aktivitetin e prokurimit me titull: "Shitja masës drusore të pa prerë në njësinë menaxhuese Novobërdë – Kodra e Madhe, me lloj të trajtimit Rrallime, me nr. të Prokurimit: NB 654 17 001 AP, ti kthej në ri- vlerësim.

IV. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim .Mos respektimi

i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

V. Operatorit ekonomik ankues "Dromodoli Comerc, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, megjithatë obligohet i njëjti që në afat prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve - sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik "Dromodoli Comerc", me seli në Pejë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: **07.04.2017**, me Nr. **102/17**, kundër njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së ne fuqi , siç janë:

- Neni - 7, 59, 60 dhe 62 të LPP-së.

Ankesa aprovohet si e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së ne fuqi, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe teknik, për të shqyrtuar pretendimet ankimore të përfshira ne ankese, te OE "Dromodoli Comerc" – Pejë. Të njëjtit ekspert në raportin e datës: 12.05.2017, kan sqaruar – trajtuar pretendimet e përfshira ne ankesë, rrjedhimisht i ka propozuar panelit shqyrtues qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne ri vlerësim, ndërsa ankesa e OE "Dromodoli Comerc" te aprovohet si e bazuar.

OE "Dromodoli Comerc", përmes parashtresës me shkrim te datës 16.05.2017 njofton panelin shqyrtues se te njëjtit pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

AK "Komuna Novobërde", po ashtu përmes parashtresës me shkrim te datës 16.05.2017 njofton panelin shqyrtues se te njëjtit nuk pajtohen me mendimin e ekspertit sh qortues.

Paneli shqyrtues konform nenit 26 të rregullores së punës se OSHP-së nr. 01/2017, vendosi që seancën ta mbaj pa prezencën e palëve, ku ishin prezent anëtarët e panelit shqyrtues si dhe eksperti shqyrtues, me ç'rast u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, raporti i vlerësimit dhe ri-vlerësimit te ofertave, rrjedhimisht eksperti shqyrtues deklaroj : "Të gjitha pretendimet ankimore dhe përgjigjet në pikat ankimore i gjeni detajisht të dhëna në raportin e ekspertizës së 12.05.2017, andaj qëndroj pran raportit të ekspertizës nr. 102/17 të datës 12.05.2017".

Paneli shqyrtues nga shkresat e lëndës gjeti se qëndron pretendimi ankimore i OE ankues se AK ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-ës sepse kompetent për anulimin e aktivitetit të prokurimit nuk mund të jetë ZKA,paneli shqyrtues i rekomandon AK që me rastin ri-vlerësimit të veproj konform dispozitave të LPP-ës .

Paneli shqyrtues duke u bazuar në provat shkresore konstatoi se me rastin e anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit nuk ka respektuar nenin 62 te LPP-se pa dhënë sqarim konfor kësaj dispozite ligjore.

Paneli shqyrtues pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke e bërë kontrollimin, analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i

inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues gjati se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-ës me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Andaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :
Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur
nuk mund të ushtron ankesë,
por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh,
pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë
kërkesë-padi në Gjykatën Themelore - Prishtinë
Departamenti për Çështje Administrative.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Tefik Sylejmani